

2024

RAPORT ARKITEKTONIK

Rikonstruksioni i Shkollës “Marash Gjoni”



D&C PARTNERS

Ark.Dorian Kushi

11/21/2024

Permbajtja

1.	HYRJE.....	2
2.	TE PERGJITHSHME	2
2.1	Gjendja Ekzistuese	2
2.2	Qellimi I Projektit.....	7
3.	Hartimi I Projektit.....	8
3.1	Konceptimi dhe standartet e projektimit.....	8

Tabela e figurave

Figure 1.	Planimetria e katit perdhe, gjendja ekzistuese	3
Figure 2.	Planimetria e katit te pare, gjendja ekzistuese	3
Figure 3.	Planimetria e katit te dyte, gjendja ekzistuese	4
Figure 4.	Planimetria e katit perdhe, gjendja e propozuar	9
Figure 5.	Planimetria e katit te pare, gjemdj e propozuar	10
Figure 6.	Planimetria e katit te dyte, gjendja e propozuar.....	10
Figure 7.	Planimetria e palestres se propozuar	11
Figure 8.	Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni.....	12
Figure 9.	Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni.....	13
Figure 10.	Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni.....	13
Figure 11.	Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni.....	14
Figure 12.	Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni.....	14

1. HYRJE

Europartners Development, në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, në kuadër të projektit "Për Barazi dhe Transparencë në Ndërhyrjet e Infrastrukturës Shkollore", financuar nga USAID dhe zbatuar nga UNICEF, kërkon të realizojë projektin për Rikonstruktionin e Shkolles "Marash Gjoni" në Rrile, Lezhë.

2. TE PERGJITHSHME

2.1 Gjendja Ekzistuese

Shkolla 9-vjecare "Marash Gjoni", ndodhet në Zonen Kadastrale me nr ZK.3181, Nr. Pasurie 5/9, Rrile, Lezhë. Siperfaqja totale e truallit për zhvillim është 3837m² me sipërfaqe të gjurmës së godinës 560m² (sipas dokumentit të pronësive të vendosura në dispozicion nga Bashkia Lezhë).

Pershkrim: Shkolla 9 - vjecare "Marash Gjoni" 3 kate, Rrile, është ndërtuar në vitin 1986 dhe rikonstruktuar në vitin 2011. Godina e shkolles është objekt tre katesh dhe mbulesa është e tipit terrace e sheshtë.

Kapaciteti: Në total frekuentojnë mesimin rreth 322 nxënës, të cilët e zhvillojnë mesimin në 18 klasa, të cilat ofrojnë kushte për mesim. Mesimi zhvillohet me një turn.

Gjendja Faktike:

Vlerësimi fizik i objektit: Megjithatë shkolla është e mirëmbajtur, vërehen probleme të cilat kërkojnë ndërhyrje sa më parë për t'i eliminuar dhe mos të rëndohen me tepër. Nga një vlerësim paraprak rezulton se:

- o Shkolla nuk ka palestër.
- o Ka nevojë për sistemi të ujërave të ftohtë, duke qenë se pasistemuara ato depertojnë në ambientet e brendshme të shkolles.
- o Ka nevojë për ndërtimin e sistemit të drenazhimit në ambientet e jashtme sportive.
- o Njësitë sanitare rrjedhin dhe japin lageshti në klasa, pajisjet hidrosanitare janë pjesërisht jashtë funksionit. Ato janë vetëm në katin përfaqësues të objektit (mungojnë në dy katet e tjera)
- o Mungon sistemi i ngrohjes, ngrohja pjesërisht me soba druri dhe rezistence.
- o Sistemi elektrik duhet të rishikohet pasi nuk mban ngarkesë.
- o Nuk ka sistem të MNZ-se.
- o Dyert kanë nevojë për riparime dhe zëvendësime si dhe dritaret.
- o Ka nevojë për rrethim të terreneve sportive si dhe për riparime të tyre.
- o Ka nevojë për riparim të rrethimit ekzistues.

Shkolla ka në përmbajtje strukturën me funksionalitetin si më poshtë:

Kati perdhe me siperfaqe totale prej 606.5m² ku ka keto ambiente:

- o 4 klasa per ciklin e shkolles
- o 2 klasa per kopeshtin se bashku me s ambiente ndihmese
- o Holli/korridoret
- o Tualetet e nxenesve per vajza dhe djem si edhe tualetet per mesuesit.




Figure 1. Planimetria e katit perdhe, gjendja ekzistuese

Kati I Pare me siperfaqe totale rreth 555m² me ambientet si:

- o 7 klasa per ciklin e shkolles me nje siperfaqe mesatare prej 37.5m²
- o Drejtoria
- o Sekretaria
- o Ambient ndihmes per edukimin fizik
- o Ambient I perbashket per Biblioteken dhe psikologun




Figure 2. Planimetria e katit te pare, gjendja ekzistuese

Kati I Dytë me sipërfaqe totale prej 555m² me ambientet si:

- o 7 klasa për ciklin e shkollës me një sipërfaqe mesatare prej 37.5m²
- o Laboratori i informatikës
- o Si edhe një ambient i investuar nga fondi amerikan.




Figure 3. Planimetria e katit të dytë, gjendja ekzistuese

Foto të gjendjes ekzistuese



Foto 1



Foto 2



Foto 3



Foto 4



Foto 5



Foto 6



Foto 7

2.2 Qellimi I Projektit

Duke iu referuar kërkesës së paraqitur në lidhje me Rikonstruksionin e shkollës ne Termat e References si edhe referuar kerkesave te listuara gjate takimit me perfaqesuesit e Bashkise Lezhe si edhe stafit te shkollës ne ambientet e shkollës Marash Gjoni date 02.10.2024, qellimi i ketij projekti eshte:

Rikonstruksioni i gjendjes ekzistuese të godines së shkolles, krijimi i një shtese anesore 3 kate, ndertimi i palestres së re të mbyllur, ndertimi i sistemit të MNZ, ndertim i sistemit kapote për eficienten energjitike, sistemimin e ujerave të shiut, zëvendësim të pajisjeve sanitare, pllakave, dyerve dhe dritareve të demtuara, riorganizim dhe gjelberim të ambientit të jashtëm dhe terreneve sportive, etj.

3. Hartimi i Projektit

3.1 Konceptimi dhe standartet e projektimit

Në projektimin e godines janë marrë parasysh të gjitha normat e aprovuara duke siguruar infrastrukturën e nevojshme për kategori të ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Janë marrë parasysh kërkesat e veçanta të aksesit për të gjithë përdoruesit: fëmijet, mësuesit dhe stafin e administratës, prindërit dhe vizitorët.

Jemi kujdesur që ti lejojmë të gjithë përdoruesit të përdorin shërbimet e disponueshme në ndërtesën e shkolles, është përdorur qasja e "skemes universale" e cila do të sigurojë që objekti të arrihet dhe të përdoret:

- 1) në masën më të madhe të mundshme,
- 2) në mënyrën më të pavarur dhe natyrore të mundshme, dhe
- 3) në gamën më të gjerë të situatave, pa pasur nevojë për adaptim, modifikim ose zgjidhje të specializuara.

Për sa i përket koncepteve të qëndrueshmërisë, janë menduar përmirësime në efikasitetin e energjisë, përmes sistemeve të montimit dhe ngrohjes së qëndrueshme. Projektimi synon të arrijë efikasitet optimal të energjisë në ndërtesë brenda kufizimeve të kostos së ndërtimit dhe parametrave lokalë.

Objektet janë konceptuar me të gjithë perberësit e tyre funksionale, siç parashikohet në Objektet arsimore do të konsiderohen me të gjithë përbërësit e tij funksionalë siç parashikohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 159, datë 10.03.2017 "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave" dhe përfshijnë sa vijon:

o Shkolla

Rikonstruksioni i godines ekzistuese nepermjet perforcimit te mureve mbajtese si edhe te soletave ekzistuese, shtesa anesore 3 kate ne anen jugore te godines, si edhe riorganizimi i ambienteve te brendshme si me poshte:

Kati perdhe siperfaqe totale prej 870.5m² me ambientet si me poshte:

- 4 Klasa për ciklin e shkolles me siperfaqe mesatare rreth 37.5m² dhe kapacitet maksimal prej 30 nxenes.
- 2 NHS për mësuesit, NHS për fëmijet vajza dhe djem të ndarë me nga 6 vende/secilin, si edhe 1 NHS për personat me aftësi të kufizuara
- 1 Laborator Fizike/Kimie

- Dhome infermierie
- Kopeshti me 3 klasa me nje kapacitet prej 30 femije/klase, i cili eshte konceptuar me hyrje me vete si edhe i ndare nga shkolla. Gjithashtu eshte menduar te lihet nje menyre komunikimi me shkollen nepermjet deres.
- Ambienti i kuzhines per kopeshtin
- NHS per femijet e kopshtit si edhe per edukatoret
- Ambienti per stafin e kopshtit me nje siperfaqe prej 36.6m2.

Per Hyrjen ne shkolle eshte parashikuar edhe ndertimi i rampave per personat me aftesi te kufizuar. Ne pjesen e jashtme te godines, eshte parashikuar edhe ambienti teknik per pajisjet, e cila nuk ka komunikim me ambientet e brendshme te shkolles. Ndersa ne pjesen fundore te korridorit eshte parashikuar edhe vendosja e ashensorit per lezjen e stafit ose edhe te personave me aftesi te kufizuar.



Figure 4. Planimetria e katit perdhe, gjendja e propozuar

Kati i Pare me nje siperfaqe totale prej 801.5m2 me ambientet si me poshte:

- 10 klasa per ciklin e shkolles 9 vjecare
- 2 NHS per vajza dhe djem te ndara me nga 6 vende secila
- 2 NHS per stafin
- 1 NHS per personat me aftesi te kufizuar
- Drejtoria
- Sekretaria
- Dhoma e psikologut



Figure 5. Planimetria e katit të pare, gjendja e propozuar

Kati i Dyte me nje siperfaqe totale prej 801.5m² me ambientet si me poshte:

- 8 klasa per ciklin e shkolles 9 vjecare
- 2 NHS per vajza dhe djem te ndara me nga 6 vende secila
- 2 NHS per stafin
- 1 NHS per personat me aftesi te kufizuar
- Ambient ndihmes/magazine
- Biblioteka
- Keshilli Pedagogjik/Dhoma e mesuesave
- Klasa e Investuar nga fondi amerikan (do ruhet sipas gjendjes ekzistuese pasi nuk nderhyhet dot).




Figure 6. Planimetria e katit të dyte, gjendja e propozuar

o Palestra

Gjithashtu ne kete projekt eshte propozuar edhe ndertimi i palstres se re te mbyllur, godine kjo e konceptuar vecmas godines ekzistuese te shkolles, me nje siperfaqe totale te gjurmes prej 403.2m2. Ne kete godine jane parashikuar te behen edhe dhomat e zhveshjes si edhe NHS.




Figure 7. Planimetria e palestres se propozuar

o Pozicionimi ne parcele

Përsa i përket pozicionimit të godinës në parcelë mund të themi se ajo është vendosur në mënyrë të tillë që fasadat kryesore janë të orientuara lindje /perendim dhe hyrja kryesore duke qene lehtesisht e arritshme nga femijet dhe punonjesit.

Pozicionimi i hyrjes në pjesën balllore të godinës e bën atë jo vetëm lehtësisht të aksesueshem nga frekuentuesit, por shërben edhe si një element formues në pamjen e objektit.

o Konceptimi arkitektonik

Qëllimi kryesor i projektit nga pikëpamja arkitektonike është që të krijojë një ambient edukativ që plotëson në mënyrë të plotë termat e referencës, një ambient që të jetë funksional dhe me hapësira të menaxhueshme, të ketë një shkallë sa më humane perceptimi si dhe të krijojë një ambient mikprites për të gjithë. Projekti synon gjithashtu të prezantojë një experiencë të re projektimi të shkollave duke përmirësuar standardet sociale të tyre, si dhe të shërbejë si një pikë sociale për komunitetin.

Godina në total ofron ambiente me funksionet e nevojshme për një fëmijë të kopshtit dhe shkollës të ditëve të sotme. Ajo sjell ambiente mësimdhënie, edukative, ambiente lojrash dhe një sërë shërbimesh të tjera.

Projekti parashikon një mbrojtje të mirë kundër zjarrit si në aspektin e specifikimeve të materialeve të përdorura ashtu edhe në aspektin e evakuimit dhe masave që përdoren për fikjen e zjarrit.

Nga ana arkitektonike projekti është trajtuar me një gjuhë bashkëkohore ekspresive. Materialet e përdorura për fasadat, në aspektin e rifiniturave, veshjeve dhe ngjyrave, të sistemimeve të jashtme, është përdorur teknologji ndërtimi bashkëkohore, por dhe e pershtatshme për zonën lokale ku po ndërtohet. Projekti trajton me hollësi të gjitha detajet e sistemit të jashtëm.

Për fasadat është përdorur sistemi i veshjes me kapote dhe suvatim me grafiato me ngjyrë. Në ambientin e jashtëm do të krijohet një zonë rekreacioni me gjelberim dhe me lojra për arëtimin e fëmijëve.

Ambjentet do të pajisen me sisteme ngrohjeje. Të gjitha dritaret janë parashikuar me dopio xham për efekt termoizolimi.



Figure 8. Pamje 3D të shkollës Marash Gjoni



Figure 9. Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni



Figure 10. Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni



Figure 11. Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni



Figure 12. Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni

Duke bere nje krahasim mes godines ekzistuese dhe asaj te propozuar per Rikonstrukcion dhe shtese anesore kemi nje shtese te siperfaqes se pergjithshme ne kat prej 225m² per secalin kat si edhe godinen e re te palestres.

Pergatiti:

Ark.Dorian Kushi